


# Historia e Agostinos



LIDA Italia  Billie Cejka Risnes  Maria Hila  Shqip  5




## LIDA Stories

[lidastories.net](http://lidastories.net)

### Historia e Agostinos


LIDA Italia  Billie Cejka Risnes  Maria Hila



This work is licensed under a Creative Commons Attribution 4.0 International License. <https://creativecommons.org/licenses/by/4.0>




Unë quhem Agostino dhe jam 51 vjeç.  
Puna ime është të shpërndaj ushqime me  
biçikletë. Unë kam dy vajza, por flasim  
shumë rrallë. Unë dhe nëna e tyre nuk  
jetojmë më bashkë pasi jemi divorcuar.




Une jetoj me nënën time, sepse pas divorcit nuk përballoj dot të paguaj qira. Qiraja është shumë e shtrenjtë në këtë qytet.




Para disa muajsh punoja si pastrues për një kompani. Riparoja sende të prishura, transportoja kuti, dhe ndihmoja kur dikush kishte nevojë. Një ditë kompania më pushoi nga puna. Nuk e kuptova arsyen pse.



Pas një kohe të gjatë, puna jonë e fortë u shpagua. Një kompanie të madhe shpërndarjesh iu desh të paguante një gjobë të majme dhe t'u jepte punëmarrësve punë të përhershme. Ishte hera e parë që kjo ndodhte në mbarë botën. Duket se gjërat po fillojnë të përmirësohen.




Shihja shume njerëz që shpërndanin ushqime me bigikete. Une di t'i jap bigiketës, trokita në derën e një kompanie të madhe shpërndarjesh. Ata më ofruan tre euro për çdo shpërndarje. Fitoj 40 euro në ditë, 60 euro nëse jam shumë me fat dhe klientët më japin bakshish.



Së bashku me shpërndarës nga kompani të tjera, ndoqa një kurs për të drejtat e punëmarrësve pranë një qendre vendore. Ata na ofruan keshillim ligjor pa pagesë. Ne u përpoqëm që të merrnim më shumë vëmendje dhe të drejta.



Nuk kam pushime të paguara, as ditë të paguara kur jam i sëmurë, pothuajse nuk kam fare të drejta. Nuk mendoj se kjo është e drejtë, por më duhet puna. Shumica e punëmarrësve të tjerë janë emigrantë nga e gjithë bota.



Shumë shpërndarës lëndohen në aksidente çdo ditë. Më pas, kur një shpërndarës 25 vjeçar u godit nga një makinë dhe vdiq, autoritetet filluan të na vinin re. Sa keq që atij iu desh të vdiste para se kjo të ndodhte.